



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS
AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN**

RAPORTI PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK

VITI 2025

Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Në funksion të përgatitjes së Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 90/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, është ndjekur procesi i detyrueshëm i konsultimit publik në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Ky proces është realizuar në përputhje me afatet dhe formatin e kërkuar, përmes platformës elektronike të konsultimeve publike RENJK (Regjistri elektronik për njoftimet e konsultimit publik). Megjithatë, gjatë periudhës së konsultimit nuk u paraqitën komente apo sugjerime nga individë, insitucione apo palë të treta të interesuara. Për rrjedhojë, nuk ka të dhëna statistikore mbi pjesëmarrjen ose çështjet e ngritura. Pavarësisht mungesës së komenteve të drejtpërdrejta, procesi i konsultimit u konsiderua si një mundësi për të promovuar transparencën institucionale dhe për të siguruar akses të hapur për çdo subjekt të interesuar. Si mësim i nxjerrë, konstatohet nevoja për forcimin e kanaleve të komunikimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe grupeve të interesit lidhur me nismat ligjore me karakter institucional e teknik, si dhe detyrim nga gjetjet e BE.

Sfidat kryesore të evidentuara lidhen me nivelin e ulët të përfshirjes së publikut në konsultime për tema me natyrë më të specializuar, ndërsa mundësitë për përmirësim në të ardhmen përfshijnë përdorimin e mjeteve më interaktive të komunikimit dhe identifikimin proaktiv të aktorëve kyç për konsultimin të drejtpërdrejtë.

1. Analiza e konsultimeve të kryera

1.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilin Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian ka zhvilluar procesin e konsultimit public është një, konkretisht:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë””.

1.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Gjatë vitit përkatës është miratuar një akt normativ, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë””.

1.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

1(një) projektakt i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

1.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

AAPAA ka hartuar dhe hedhur për konsultim publik vetëm një projektligj, për të cilin është përgatitur dhe publikuar gjithashtu një raport i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR), në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

1.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

N/A

1.1.3. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

1 Projektligj.

1.1.4. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

N/A

1.2. Metodat e konsultimit

1.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

AAPAA ka përdorur metodën elektronike të konsultimeve publike RENJK (Regjistri elektronik për njoftimet e konsultimit publik).

1.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike, sipas ligjit nr. 146/2014. Për shkak të natyrës teknike dhe specifike të tij, nuk janë paraqitur komente. Megjithatë, metoda elektronike vlerësohet si transparente dhe efikase për përfshirjen publike në procesin ligjvënës.

1.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Gjatë fazës së hartimit të projektligjit, institucioni zhvilloi një konsultim paraprak me Kryeministrinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme NEAR (DG NEAR) të Komisionit Evropian. Ky konsultim shërbeu për të adresuar elementët teknikë dhe për të siguruar përputhshmëri me kërkesat e Bashkimit Evropian.

1.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

1.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Kohëzgjatja e konsultimeve publike në kuadër të hartimit të Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, u konsultua specifikisht për 20 ditë pune.

1.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja e konsultimit për Projektligjin Nr. 90/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, ka qënë 20 ditë pune.

1.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Duke qënë se institucioni ynë nuk ka pasur më parë raste të ngjashme të organizimit të konsultimeve publike për projektakte të kësaj natyre, aktualisht nuk disponohet një praktikë referuese për të realizuar krahasimin ndër vite. Megjithatë, zhvillimi i konsultimit përmes platformës elektronike vlerësohet si hap pozitiv drejt konsolidimit të transparencës dhe pjesëmarrjes publike në procesin legjislativ.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të hartimit të Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, nuk është përfshirë asnjë aktor i jashtëm.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

N/A

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

N/A

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

N/A

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

N/A

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Gjatë periudhës së konsultimit publik për projektligjin nuk janë paraqitur rekomandime apo komente nga publiku apo palët e interesuara. Si rrjedhojë, numri i përgjithshëm i tyre është zero dhe mesatarja për konsultim mbetet zero.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

N/A

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

N/A

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Gjatë procesit të konsultimit publik nuk janë paraqitur komente apo informacion shtesë nga publiku. Si rrjedhojë, nuk është kryer asnjë ndryshim apo përditësim në përmbajtjen e raportit VNR-së.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për aktin në lidhje me Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, të publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJK), për të cilin është përmbyllur afati i konsultimit, institucioni ka publikuar raportin përkatës të konsultimit, në përputhje me rezultatet e këtij procesi.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Në kuadër të procesit të konsultimit publik për projektligjin, të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë raportin përfundimtar të konsultimit, janë publikuar në RENJK, në përputhje me afatet dhe detyrimet ligjore. Nuk ka pasur raste të mospublikimit.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

AAPAA vlerëson se ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe në kohë kërkesat ligjore që burojnë nga Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Procesi i njoftimit dhe konsultimit është kryer në përputhje me standartet e transparencës duke përdorur platformën elektronike për këtë qëllim, Regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit.

Pavarësisht përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe proceduriale, mungesa e komenteve apo pjesëmarrjes nga palët e interesuara ka ndikuar në vlerësimin e përgjithshëm të performancës. Në këtë drejtim, vetëvlerësimi insitucional konsideron se:

- Transparenca dhe përputhshmëria me ligjin ishin në nivel të kenaqshëm.
- Përfshirja e aktorëve të jashtëm rezultoi ulët, çka reflekton një sfidë në fushën e ndërveprimit dhe angazhimit të grupeve të interesit.
- Dokumentimi dhe gjurmueshmëria e procesit janë realizuar plotësisht, duke mundësuar verifikim të çdo hapi të ndërmarrë.

Në këtë kuadër AAPAA vlerëson si një hap të rëndësishëm dhe të nevojshëm rritjen e kapaciteteve për njoftim më efektiv, përzgjedhjen më të synuar të aktorëve për konsultim dhe përdorimin e mjeteve më tërheqëse për komunikim publik.

3 **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat e hasura gjatë procesit të hartimit dhe konsultimit të Projektligjit “Për Agjencinë e Auditimit të Programeve dhe Asistencës së Akredituar nga BE” kanë qenë kryesisht të lidhura me:

- Interesin e kufizuar publik për një nismë me natyrë të specializuar dhe teknike, që prek fusha të ngushta të administratës dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.
- Vështirësinë për të angazhuar aktorë të jashtëm, përfshirë organizata të shoqërisë civile apo ekspertë të fushës, për shkak të mungesës së njohurive të drejtpërdrejta mbi objektin e ligjit.
- Kufizimet kohore në zhvillimin e fushatave më të gjera ndërgjegjësuere, që do të mundësonin një përfshirje më të gjerë të publikut.

Megjithatë, nga kjo përvojë lindin edhe mundësi konkrete për përmirësim, si:

- Përdorimi më efektiv i kanaleve alternative të komunikimit publik, përfshirë rrjetet sociale, ftesa të drejtpërdrejta ndaj grupeve të interesit dhe aktivitete informuese paraprake.
- Hartimi i materialeve informuese të thjeshtuara, për të rritur kuptueshmërinë dhe qasjen ndaj nismave ligjore nga një publik më i gjerë.
- Identifikimi dhe përfshirja proaktive e aktorëve kyç, përmes databazave të interesit institucional apo rrjeteve të bashkëpunimit ndërsektorial.
- Forcimi i kapaciteteve të brendshme institucionale për komunikim strategjik, në mënyrë që proceset e konsultimit të shihen jo vetëm si detyrim ligjor, por si mekanizëm i vlefshëm për rritjen e cilësisë së politikëbërjes